



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°8/2022

Hagë, 03/03/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Ditën e martë të kësaj jave, në çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, Kryetarja e DHSK-së Trendafilova caktoi një Panel të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me referimet nga Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi, të cilat u dorëzuan më 28 shkurt.

Referimet lidhen, ndër të tjera, me kundërshtimin e juridiksionit të DHSK-së, ligjshmërinë e akuzave të ngritura për formën e përgjegjësisë penale të njohur si ndërmarrje kriminale e përbashkët, si dhe shkeljen e pretenduar të të drejtave themelore.

Vendimi i Kryetares për caktimin e Panelit dhe tre referimet drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese mund t'i gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Nesër, më 4 mars në orën 14:30, është planifikuar konferenca e gjashtë mbi ecurinë në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*.

Në këtë seancë të procedurës paraprake është planifikuar që palët të diskutojnë aspekte që përfshijnë nxjerrjen e provave nga Prokuroria për Mbrojtjen, ecurinë e hetimeve nga të dyja palët, si dhe të diskutojnë mes tyre mbi pikat juridike dhe faktike për të cilat pajtohen.

Të martën e ardhshme, më 8 mars, është planifikuar konferenca përgatitore e Mbrojtjes në gjykimin e Salih Mustafës.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°8/2022

Hagë, 03/03/2022

Duke përmbledhur hapat proceduralë në gjykimin e Salih Mustafës: Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave të veta dhe 13 dëshmitarët e thirrur prej Prokurorisë dhanë dëshmi para Trupit Gjykses.

Faza e ardhshme e gjykimit do të fokusohet në paraqitjen e provave nga Mbrojtja.

Qëllimi i seancës së të martës së ardhshme është lehtësimi i përgatitjeve për fazën e ardhshme të gjykimit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

